

Takimi i 25-të i Bordit të Këshillit të Bashkëpunimit

Rajonal (RCC)

Sarajevë, 26 shkurt 2015



Në Sarajevë u mbajt takimi i 25-të i Bordit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), i pari për këtë vit. Takimi u bashkë - drejtua nga Kryesia shqiptare e SEECP-së dhe Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së.

Bordi diskutoi dhe miratoi Raportin lidhur me aktivitetet më të rëndësishme të Sekretariatit të RCC-së për periudhën 21 shtator - 31 dhjetor 2014. Njëkohësisht u diskutua edhe lidhur me aktivitetet e parashikuara, në kuadër të implementimit të Strategjisë dhe Programit të Punës të RCC-së, për periudhën 2014-2016.

Përfaqësuesi i kryesisë shqiptare të SEECP-së gjatë fjalës së tij nënvizoi se marrëdhëniet me Sekretariatit të RCC-së, përfaqësojnë një pikë të fortë të kësaj kryesie. Duke evidentuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në kuadër të SEECP-së, ai theksoi rëndësinë e mbështetjes të RCC-së për organizimin e suksesshëm të ministerialeve të planifikuara në kalendarin e aktiviteteve të kryesisë.

Pala shqiptare informoi për takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve pjesëmarrëse në SEECP, i cili u mbajt në Tiranë më 24 shkurt 2015. U evidentuan temat kryesore të diskutimeve si: zhvillimet e fundit në rajon, situata politike, niveli i bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, si elementët thelbësorë që karakterizojnë zhvillimet në Evropën Jug- Lindore.

Presidenca shqiptare informoi lidhur me deklaratën e përbashkët kundër terrorizmit, e cila u miratua gjatë takimit të Tiranës, duke nënvizuar se ky dokument synon të japë një mesazh të fortë uniteti dhe serioziteti në trajtimin e sfidave të përbashkëta përmes veprimeve të përbashkëta.

Gjithashtu takimi u informua lidhur me aktivitetet kryesore të zhvilluara, si dhe ato që parashikohen të zhvillohen, në kuadër të realizimit të prioriteteve të Kryesisë shqiptare, gjatë periudhës 2014-2015.

Mbledhja u informua edhe lidhur me konkluzionet kryesore të Takimit Koordinues ndërmjet Trojkës së SEECP-së, RCC-së dhe përfaqësuesve të Bashkimit Evropian, mbajtur në Tiranë në 24 shkurt 2015.

Gjithashtu, bazuar në kërkesat e statutit të RCC-së, kryesia shqiptare informoi Bordin lidhur me ecurinë e procesit të zgjedhjes/rizgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm të RCC-së. Në këtë kuadër u bë me dije se, pas përfundimit të afatit të paraqitjes së kandidaturave, kryesia shqiptare do të vazhdojë të veprojë në përputhje me Statutin e RCC-së, deri në përfundimin me sukses të proceduarave.